

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPAK zbërthen një tjetër Call Center mashtrues te "Rruga e Kavajës", paratë që ua merrnin europianëve i kthenin në kriptovaluta, ekzekutohen 8 masa sigurie
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/zhvatinin-para-dhe-i-kthenin-ne-kriptovaluta-spak-godet-grupin-e-masht-i400877
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 11:38:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 11:34:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ed7e175a901496379e5b92d65491d9a606e7c804c1cc0973348389c77cf505f2
TEKSTI	e51ae03cdb7bbffc00f7498e9a136880a83fdce95a1b260e435f9896f7d3ee66
PAMJA	5053147e232eaf2190c73280134572e7187d3f2257b4d720d9c79cb62cbbf7f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	37a3552892deb00a4b8b08cf0bed429b902473306d2930bac94a75c60e0626a5
E MËPARSHMJA	7196127eb993979e73285dfc79f2482a06dd2fafc1116c6b7a360b0ee11eb0fa
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/37a3552892deb00a4b8b08cf0bed429b902473306d2930bac94a75c60e0626a5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Aktualitet](#) 10 Shtator 2026, 13:34

SPAK zbërthen një tjetër Call Center mashtrues të "Rruga e Kavajës", paratë që ua merrnin europianëve i kthenin në kriptovaluta, ekzekutohen 8 masa sigurie

Shkruar nga Newsbomb



 SPAK zbërthen një tjetër Call Center mashtrues të "Rruga e SPAK

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka ekzekutuar 8 nga 11 masat e sigurie ndaj shtetasve shqiptarë të cilët dyshohen si pjesëmarrës në grup të strukturuar kriminal i cili merrej me mashtrim kompjuterik përmes shitjeve "online".

Sipas njoftimit të SPAK, mësohet se masat e sigurisë janë ekzekutuar ditën e djeshme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar. Kjo si rezultat i hetimeve të nisur në vitin 2022, pas kontrolleve dhe sekuestimeve në **Rrugën e Kavajës te qendra e Thirrjeve "Bluenergycall shpk"**.

Sipas njoftimit të SPAK masat e sigurisë janë: "Gj. G.Sh dhe E.P – "Arrest me burg", si persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale;"Mashttrim kompjuterik", në bashkëpunim, në dëm të disa personave, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal", Gj. K. B. dhe I.G – "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, të dyshuar për veprën penale të "Mashttrim kompjuterik", në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", Gj dhe Dh.L – "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si të dyshuar për veprat penale të "Mashttrim kompjuterik", në bashkëpunim."

SPAK ka bërre me dije se në bazë të provave materiale të sekuestruara, dhe hetimet në bashkëpunim me autoritetet gjermane rezultojn se **shtetasit gjermanë dhe shtetasë të tjerë europianë ftoheshin nga agjentët e "Bluenergycall shpk" për të investuar në bursa ndërkombëtare përmes depozitimit të parave në platforma mashtruese. Depozitimet e parave bëheshin në llogari bankare të vendeve të ndryshme si: Bullgari, Lituan, Poloni, Qipro etj, në vende të tjera europiane dhe më gjerë dhe më pas zhdukeshin përmes transfertave të njëpasnjëshme ose konvertimit në kriptovalutë.** Gjithashtu është vërtetuar se mashtrimet janë kryer përmes dy adresave IP, të përdorura nga subjekti "Bluenergycall shpk", në Shqipëri.

Në kuadër të këtij hetimi, Prokuroria e Posaçme ka dërguar fillimisht për gjykim pronarin, IT-në e qendrës së thirrjeve, "Bluenergycall shpk", të akuzuar për kryerjen e veprës penale; "Mashttrim kompjuterik", në bashkëpunimin, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Krijimit dhe pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal"

Njoftimi i SPAK:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në vazhdim të punës hetimore lidhur me procedimin penal nr.300/1 të vitit 2021, në kuadër të Skuadrës së Përbashkët Hetimore me Prokurorinë e Bambergut Gjermani, ekzekutoi 8 nga 11 masat e sigurisë ndaj shtetasve shqiptarë, të dyshuar si pjesëtarë të një grupi të strukturuar kriminal, që merrej me veprimtarinë e paligjshme të mashtrimit kompjuterik përmes shitjeve online.

Masat e sigurisë janë ekzekutuar, të mërkurën më 9.9.2026 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, si rezultat i veprimeve hetimore të nisura pas kontrolleve dhe sekuestimeve të pajisjeve elektronike, më 16.3.2022, në subjektin, qendra e thirrjeve "Bluenergycall shpk", (Njësia Bashkiake nr.7, rruga e Kavajës, Condor Center, Tiranë).

Masat e sigurimit të ekzekutuara janë si vijon:

Gj. G.Sh dhe E.P – “Arrest me burg”, si persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale; “Mashttrim kompjuterik”, në bashkëpunim, në dëm të disa personave, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 143/b/2, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Gj. K. B. dhe I.G – “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, të dyshuar për veprën penale të “Mashttrimit kompjuterik”, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grup i strukturuar kriminal”, “Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 143/b/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Gj dhe Dh.L – “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si të dyshuar për veprat penale të “Mashttrim kompjuterik”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 143/b paragrafi 2 të Kodit Penal.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e regjistroi procedimin penal nr.300, më datë 9.12.2021 për veprat penale: “Mashttrim kompjuterik”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar si veprë penale nga nenet 143/b, 28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Mbi bazën e kërkesës për ndihmë juridike të autoriteteve gjermane të drejtësisë, përkatësisht, Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme Bamberg dhe në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO) më 16.3.2022 janë kryer kontrole në ambientet e subjektit “Bluenergycall shpk” dhe subjekteve të lidhura me të.

Skema e mashtimit

Nga provat materiale të sekuestruara dhe nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr.300 të vitit 2021, të përpunuara në bashkëpunim me autoritetet gjyqësore gjermane, ka rezultuar se shtetasit gjermanë dhe shtetasë të tjerë europianë ftoheshin nga agjentët e “Bluenergycall shpk” për të investuar në bursa ndërkombëtare përmes depozitimit të parave në platforma mashtroese. Depozitimet e parave bëheshin në llogari bankare të vendeve të ndryshme si; Bullgari, Lituan, Poloni, Qipro etj, në vende të tjera europiane dhe më gjerë dhe më pas zhdukeshin përmes transfertave të njëpasnjëshme ose konvertimit në kriptovalutë. Gjithashtu është vërtetuar se mashtrimet janë kryer përmes dy adresave IP, të përdorura nga subjekti “Bluenergycall shpk”, në Shqipëri. Gjatë kontrollit të kryer në datë 16.3.2022, janë ekstraktuar të dhënat elektronike të drejtpërdrejta që janë analizuar nga autoritetet gjermane të drejtësisë dhe konkretisht, nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme Bamberg për krimet kibernetike.

Në kuadër të këtij hetimi, Prokuroria e Posaçme ka dërguar fillimisht për gjykim pronarin, IT-në e qendrës së thirrjeve, “Bluenergycall shpk”, të akuzuar për kryerjen e veprës penale; “Mashttrim kompjuterik”, në bashkëpunimin, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Krijimit dhe pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 143/b/2, 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal, si dhe 11 shtetasë të tjerë, të akuzuar vetëm për kryerjen e veprës penale: “Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal. (shiko njoftimin datë 16.6.2023)

Hetimet për personat e paidentifikuar, të përfshirë në këtë veprimtarinë vazhduan në kuadër të procedimit të ndarë 300/1 të vitit 2021.

Masat sigurimit të ekzekutuara ditën e djeshme, janë rezultai i një pune voluminoze për analizimin e hollësishëm të të dhënave kompjuterike, të krahasuara edhe me prova të tjera fizike, si edhe kontroleve të përmendura më sipër, përmes të cilëve është mundësuar identifikimi i anëtarëve të tjerë të grupit të strukturuar kriminal.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Aktualitet

[Protestuesit në Marinëz takim me përfaqësuesit e Bankers, njërin prej tyre u përpoqën ta “tundnin”: Uli protestat, do të japim 5 milionë \(VIDEO\)](#)

E Enjte 13:24

Aktualitet

[Me automatikë dhe pistoletë kërcënuan dy persona pas një sherri me një të mitur, blutë e Shkodrës shpallin në kërkim 2 autorët](#)

E Enjte 13:09

Aktualitet

[Tre të rejtat e tërhoqën për flokësh dhe e rrahën, flet për herë të parë 17-vjeçarja që u dhunua në Fier: Më thanë pse e ke puthur të dashurin tim?! \(INTERVISTA E PLOTË\)](#)

E Enjte 12:59

Aktualitet

[Policia njoftoi shoqërimin e 16 protestuesve, qytetarët nuk humbin kohë, bëhen bashkë dhe nisen për te Komisariati numër 3](#)

E Enjte 12:45 Newsbomb

Aktualitet

[Shpërthimi tek “Eida” në Brryl, çfarë DËSHMUAN tre punonjësit e plagosur: Po furnizonim një makinë me gaz kur...](#)

E Enjte 12:22

Aktualitet

[Kontrollet e makinave luksoze “ngjiten” në veri, sekuestrohet “Rolls-Royce” i lezhjanit që jeton në Angli \(PAMJE-DETAJE\)](#)

E Enjte 12:03

Aktualitet

[16 protestues në pranga pas protestës së djeshme, Policia del me reagim zyrtar: Dy prej tyre shfrytëzuan momentin për të shitur drogë](#)

E Enjte 11:57 Newsbomb

Aktualitet

[Bllokimi i pagave të magistratëve, KALLËZOHET në SPAK ministri Petrit Malaj](#)

E Enjte 11:40

Aktualitet

[Gjyqtarët pa lekë, qytetarët në “hall”, magistratët bojkotojnë punën, preken Tirana, Durrësi dhe Berat](#)

E Enjte 11:40 Newsbomb

Aktualitet

[Dy zyrtarët e Bashkisë Tropojë u ndaluan pas vdekjes së punonjësit në krye të detyrës, Ndriçim Gjocaj dhe Gëzim Hasanpapaj do të hetohen në gjendje të lirë](#)

E Enjte 11:22

Aktualitet

[Prej tre ditësh pa gjurmë, familjarët e Saxhide Dishës nga Rrogozhina apelojnë për ndihmë: Na ndihmoni ta gjejmë](#)

E Enjte 10:58

Aktualitet

[Ngërçi me pagat, Sokol Sadushi në një mbledhje të jashtëzakonshme i drejtohet shtetit: Nuk jemi kundërshtarët tuaj, nga përplasja jonë s'fiton askush](#)

E Enjte 10:41

Aktualitet

[Pesë ditë në flakë mali i Tërbunit në Pukë, banorët kërkojnë ndërhyrje nga ajri: Është shkruar 60% të sipërfaqes](#)

E Enjte 10:40

Aktualitet

[ARRESTOHET çifti i moshuar në Gjirakare, efektivët u gjejnë dy thasë me hashash të tharë në cep të shtëpisë dhe 270 rrënjë të mbjella](#)

E Enjte 10:23 Newsbomb

Aktualitet

[Tentuan t'i shpëtonin policisë në Korçë, pasagjeri hedh qesen me drogë nga makina dhe shoferi u arratis, përfundon në pranga 31-vjeçari nga Vlora](#)

E Enjte 10:21

Aktualitet

[Anëtarët e grupit Çopja dhunojnë brutalisht drejtorin e Ujës-jellës të Elbasanit, kishte pushuar nga puna gruan e personit që do të hiqte qafe gazetarin Saimir Kodra](#)

E Enjte 10:07

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Bota

[Zelensky udhëton drejt Kanadasë, kërkon mbrojtjen e qiellit Ukrainas për dimër](#)

E Enjte 14:06

Rajoni

[LAJMI I FUNDIT/ Prokuroria në Hagë kërkon 6 vite BURG për Hashim Thaçin](#)

E Enjte 14:00

[Zbulohet më shumë artikuj](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)



[E pazakontë tek "Mbretëresha Geraldinë", vjen në jetë në lindje me natyrë djali me peshë 5.1 kg](#)



[Goditet grupi i drogës në Sarandë, 20 persona të prangosur, shpërndanin lëndën narkotike](#)

op
ed

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse “Jo”-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33



-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtori i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

Merr lajme me email

ME REGJISTRO

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.